

DOSJE TENDERI – PROCEDURA “SHPREHJE E INTERESIT”

Për Projektin:

Marrje në Menaxhim dhe Modernizim të Pritoreve të Autobuseve në Prishtinë

Ftesë për Shprehje Interesi

Komuna e Prishtinës fton kompanitë e interesuara për partneritet në kompletimin, modernizimin dhe mirëmbajtjen e pritoreve të autobuseve në qytet. Ky proces synon përmirësimin e infrastrukturës urbane dhe zhvillimin e hapësirave reklamuese përmes zgjidhjeve inovative.

Kompania e përzgjedhur do të ketë të drejtën e shfrytëzimit të pritoreve si hapësira reklamuese për një periudhë prej 5 vitesh, në këmbim të investimeve për modernizim dhe mirëmbajtje. Shërbimet do të përcaktohen pas propozimeve të paraqitura dhe konsultimeve të mëtejshme me operatorët e interesuar.

Ky është një proces i hapur që fillon një ditë pas publikimit të këtij njoftimi dhe vazhdon me lidhjen e marrëveshjeve të veçanta me operatorët e përzgjedhur.

Kriteret për Kualifikim

Për të qenë pjesë e këtij partneriteti, kompanitë duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

1. Kapaciteti Financiar

- Pasqyra financiare të audituara për vitet 2022, 2023, 2024.
- Qarkullim total prej të paktën **3 milionë EUR** për periudhën e përmendur.

2. Eksperienca në Marketing të Jashtëm

- Listë e referencave të projekteve të përfunduara në fushën e marketingut të jashtëm, me vlerë të paktën **1 milionë EUR** gjatë tre viteve të fundit.
- Referencat duhet të konfirmohen me transaksione bankare.

3. Aplikacion për Menaxhimin e Hapësirave Reklamuese

- Aplikacion funksional i gatshëm për prezantim.
- Duhet të përmbajë: a) Module për menaxhimin e reklamave digjitale dhe organizimin e rezervimeve. b) Deklaratë të noterizuar për posedimin e kodit

burimor dhe të drejtave të pronësisë intelektuale. c) Pamje skenike (screenshots) që demonstrojnë funksionalitetin e menaxhimit të reklamave.

4. Aplikacion për Menaxhimin e Orareve të Autobusëve

- Aplikacion funksional i gatshëm për prezantim.
- Duhet të përmbajë: a) Kopje e certifikatës së regjistrimit në **Apple Store** dhe **Google Play Store**. b) Deklaratë të noterizuar për posedimin e kodit burimor dhe të drejtave të pronësisë intelektuale. c) Pamje skenike të aplikacionit që tregon funksionalitetin e shfaqjes së orareve në kohë reale. d) Module për menaxhimin e orareve nga distanca. e) Module për lidhjen me **GPS**, për përcjelljen dhe shfaqjen e pozicionit të autobusëve në kohë reale.

5. Infrastrukturë dhe Pajisje

- Marrëveshje me një operator të licencuar në Kosovë për furnizim të rregullt me internet (shpejtësi ≥ 50 Mbps).
- Katalog me specifikimet teknike të monitoreve reklamuese dhe monitoreve të orareve, përfshirë: a) Rezolucionin dhe rezistencën ndaj kushteve atmosferike. b) Sinkronizimin në kohë reale dhe qëndrueshmërinë e pajisjeve.
- Autorizime të prodhuesit për të dy llojet e monitoreve, të vulosura dhe të nënshkruara.

Kriteret e Vlerësimit

Kriteri	Pesha	Metoda e Vlerësimit
Teknologjia e Aplikacioneve	25%	Verifikimi i kodit burimor dhe funksionalitetit
Cilësia e Monitoreve	25%	Vlerësim teknik i mostrave dhe autorizimeve
Qarkullimi Financiar	25%	Auditimi i pasqyrave financiare
Eksperienca në Marketing	25%	Verifikim i transaksioneve dhe referencave

Procedura e Aplikimit

Kompanitë e interesuara duhet të dorëzojnë aplikacionet e tyre së bashku me dokumentacionin përkatës brenda afatit të përcaktuar. Pas shqyrtimit të dokumentacionit, do të organizohen takime të drejtpërdrejta për të diskutuar më tej mbi propozimet dhe kushtet e bashkëpunimit.

- **Koha e aplikimit:** 14.05.2025 – 23.05.2025
 - **Procedura e dorëzimit të aplikacioneve:** Aplikimi bëhet në formë elektronike, përmes emailit: SherbimetPublike.Pr@rks-gov.net
 - **Adresa kontaktuese për informata shitesë:** Komuna e Prishtinës, Drejtoria e Shërbimeve Publike – SherbimetPublike.Pr@rks-gov.net
-